



REPubLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  VRHOVNI SUD KOSOVA
G.J.A-Su.A 051/2025
Dt: 09.01.2025
PRISHTINË - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS SË GJYKATËS
SUPREME
(Janar - Dhjetor 2025)



Janar, 2025

FJALA E KRYETARIT

Në përputhje me mandatin e saj kushtetues, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, si instanca më e lartë gjyqësore në vend, do të vazhdojë të angazhohet për përmbushjen e detyrave të saj me përkushtim, profesionalizëm dhe transparencë.

Plani i Punës për vitin 2025, duke qenë një udhërrëfyes i punës dhe angazhimit, synon të përmirësojë më tej efikasitetin e gjykatës dhe të forcojë besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Në kuadër të kësaj, do të përqendrohemi në avancimin e komunikimit me publikun, përmes një bashkëpunimi aktiv me mediat. Synojmë të përmirësojmë marrëdhëniet me publikun, duke ofruar informacion të qartë dhe të nevojshëm, dhe rritur ndërgjegjësimin për funksionimin e sistemit gjyqësor.

Kjo gjykatë e ka përmbyllur vitin 2024 me shkallë të efikasitetit në kryerjen e lëndëve prej 92.43%. Lëndët në Gjykatën Supreme trajtohen dhe zgjidhen brenda afateve të arsyeshme ligjore. Këtë vit, planifikojmë që shkalla e këtij efikasiteti të rritet, për shkak se Gjykatës Supreme i janë shtuar edhe pesë gjyqtarë të rinj. Poashtu, Gjykata Supreme ka arritur të plotësojë numrin e tërësishëm të pozitave të lejuara të gjyqtarëve, duke kontribuar kështu në rritjen e kapaciteteve për trajtimin e çështjeve me efikasitet.

Në thelb të punës sonë qëndron respektimi i standardeve më të larta ligjore dhe etike. Prandaj, do të përqendrohemi në forcimin e transparencës përmes publikimit të vendimeve, mendimeve juridike, qëndrimeve parimore, udhëzuesve, përmbledhjeve të ndryshe, duke u siguruar që qytetarët të kenë qasje të lehtë dhe të plotë në informacionet lidhur me punën tonë. Kjo është një shprehje e përkushtimit tonë ndaj drejtësisë dhe barazisë dhe do të ndihmojë në forcimin e besimit të publikut te sistemi gjyqësor.

Për më tepër, do të intensifikojmë përpjekjet për digjitalizimin e shërbimeve gjyqësore. Përdorimi i teknologjisë së avancuar për menaxhimin e çështjeve dhe ofrimin e shërbimeve do ta bëjë sistemin tonë më të qasshëm dhe më efikas. Ky transformim digjital ka për qëllim jo vetëm modernizimin e shërbimeve, por edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Gjykata Supreme është e përkushtuar që në vitin 2025 të forcojë më tej rolin e saj si garantuese e shtetit të së drejtës, duke mbrojtur të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe duke siguruar një drejtësi të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Gjatë kësaj periudhe, bashkëpunimi me institucionet vendore të drejtësisë, por edhe me partnerët ndërkombëtarë do të forcohet, për të avancuar drejtësinë dhe për të siguruar zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimeve. Synimi ynë përfundimtar është të rrisim besimin e qytetarëve në drejtësi dhe të përmirësojmë funksionimin e Gjykatës Supreme, duke siguruar një sistem gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm.

Fejzullah Rexhepi

Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Përmbajtja e Planit dhe Programit të Punës

1. Organizimi i punës në Gjykatën Supreme.....	4
1.1 Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e degëve të Gjykatës	4
1.3 Përbërja e Kolegjeve	6
1.4 Ndarja e lëndëve	6
1.5 Orari vjetor i punës së Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme	6
1.6 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.....	12
2. Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme.....	12
3. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes	12
4. Zbatimi i programit TIK/SMIL	13
5. Implementimi i Sistemit të Përkthimeve.....	13
6. Transparenca dhe llogaridhënia.....	14
6.1 Praktika Gjyqësore.....	14
7. Administrata Gjyqësore	14
8. Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.....	15
10. Bashkëpunimi me institucionet të tjera	15
Përfundimi.....	16

1. Organizimi i punës në Gjykatën Supreme

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës udhëheqë kryetari i gjykatës, Fejzullah Rexhepi. Në mungesë të kryetarit me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës do të udhëheq nënkryetarja Mejreme Memaj. Në rastet kur nuk mund të nënshkruhen vendimet nga nënkryetarja e gjykatës, ato i nënshkruan gjyqtari më i vjetër i Gjykatës Supreme.

Me organizimin e punës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme udhëheq – u.d. gjyqtari mbikëqyrës Sahit Sylejmani.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimin e objektit, merret ushtruesja e detyrës së administratores Vjollca Cenaj.

1.1 Funkzionet gjyqësore dhe udhëheqja e degëve të Gjykatës


Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga tre (3) gjyqtarë profesionist, me përjashtim kur me ligj parashihet një numër më i madh i gjyqtarëve.

Në kuadër të Gjykatës Supreme funksionojnë degët gjyqësore:

- Dega penale,
- Dega civile,
- Dega administrative

Aktualisht, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në përbërje të saj ka 19 gjyqtarë, përfshirë kryetarin, dhe kryesuesin e KGJK-së, i cili e ka të pezulluar punën në gjykatë.

Përbërja e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme është si vijon:





Gjyqtarët Bashkim Hyseni dhe Burim Ademi do të fillojnë punën në Gjykatën Supreme të Kosovës nga data 01.02.2025. Andaj plani vjetor për këta gjyqtarë do të aplikohet nga kjo datë.

Gjykata Supreme, në përputhje me mandatin e saj kushtetues dhe ligjor, kryen praktikën gjyqësore me udhëheqës të caktuar si më poshtë:

- Gjyqtarja Valdete Daka për çështjet penale, me zëvendës gjyqtarin Agim Maliqi.
- Gjyqtari Rustem Thaqi për çështjet civile, me zëvendës gjyqtarin Beshir Islami.

Në Degën Penale, udhëheqëse caktohet gjyqtarja Mejreme Memaj, zëvendës, gjyqtari Agim Maliqi.

Në Degën Civile - Komerciale, udhëheqës caktohet gjyqtari Rustem Thaqi, ndërsa zëvendës, Beshir Islami.

Në Degën Administrative janë të caktuar gjyqtarët Ragip Namani, Delushe Halimi, Franciska Zhitija Ymeri e cila do të ngarkohet me lëndët administrative të cilat vijnë nga Gjykata Komerciale, dhe Lumni Sallauka si bartës i lëndëve në rastet kur përjashtohen gjyqtarët tjerë të caktuar në çështjet administrative. Ndërsa anëtarë të kolegjit do të jenë edhe gjyqtarët tjerë të degës civile sipas përzgjedhjes së SMIL-it, ndërsa në lëndët pa SMIL anëtar do të jetë gjyqtari Zenel Leku. Për degën administrative, udhëheqës caktohet gjyqtari Ragip Namani deri në pensionimin e tij më datë 19.04.2025, ndërsa pas kësaj date do të jetë gjyqtarja Delushe Halimi.

Udhëheqësit e degëve do t'i raportojnë Kryetarit të Gjykatës për punën e degëve gjyqësore, së paku njëherë në tre (3) muaj. Pjesë e raporteve të udhëheqësve, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të degëve.

Në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme do të punojnë:

- Beshir Islami
- Ragip Namani
- Nenad Lazic
- Ankesat në shkallë të tretë i kryeson kryetari apo nënkryetarja e Gjykatës.

1.3 Përbërja e Kolegjeve

Të gjitha çështjet në Degën Penale të Gjykatës Supreme gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarësh profesional, nga të cilët njëri duhet të jetë kryetar i trupit gjykues.

Të gjitha çështjet në Degën Civile gjykohen nga tre (3) gjyqtarë, përveç nëse me ligj parashihet ndryshë. Kolegje prej tre gjyqtarësh parashihen edhe për degën administrative dhe për lëndët në Kolegjin e Apelit.

Në çështjet ku palë janë të miturit, udhëheq gjyqtari Afrim Shala.

Plani dhe orari vjetor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nuk është përfshirë në këtë material.

1.4 Ndarja e lëndëve

Lëndët në Gjykatë Supreme ndahen në mënyrë elektronike përmes Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve – SMIL. Nëse gjyqtarit, të cilit i është caktuar lënda duhet përjashtuar nga arsyet e ndryshme, kërkesa për përjashtim duhet të bëhet tek Kryetari. Në rastet kur paraqitet nevoja e ndryshimit të kolegjit të paracaktuar me SMIL, kërkesa bëhet tek Kryetari për të gjitha ndryshimet e kolegjit, dhe ndryshim bëhet përmes sistemit SMIL.

1.5 Orari vjetor i punës së Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme

Kryetari i Gjykatës Supreme Fejzullah Rexhepi, në bazë të Ligjit për Gjykatat e Rregullta të Kosovës, nenit 25, paragrafit 7, cakton orarin vjetor të punës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për periudhën 01.01.2025 deri 31.12.2025. **Ky orar vlen në rastet kur kolegji i çështjeve, nuk është paracaktuar me SMIL.**

DEGA PENALE

Kolegji i parë në çështje penale me mjete të jashtëzakonshme juridike.

1. Valdete Daka, kryetare,

2. Agim Maliqi, anëtar dhe

3. Burim Ademi, anëtar.

Kolegji i dytë në çështje penale me mjete të jashtëzakonshme juridike.

1. Mejreme Memaj, kryetare,

2. Afrim Shala, anëtar

3. Bashkim Hyseni, anëtar

Kolegji i tretë në çështje penale me mjete të jashtëzakonshme juridike.

1. Agim Maliqi, kryetar

2. Mejreme Memaj, anëtare

3. Rasim Rasimi, anëtar.

Kolegji i parë për paraburgime

1. Agim Maliqi, kryetar

2. Valdete Daka, anëtare

3. Rasim Rasimi, anëtar.

Kolegji i dytë për paraburgime

1. Valdete Daka, kryetare,

2. Afrim Shala, anëtar

3. Mejreme Memaj anëtare.

Kolegji i tretë për paraburgime

1. Mejreme Memaj, kryetare
2. Bashkim Hyseni, anëtar dhe
3. Burim Ademi, anëtar.

Kolegjet veprojnë nga një muaj, duke filluar në muajin janar me kolegjin e parë, në muajin shkurt me kolegjin e dytë, në muajin mars me kolegjin e tretë, duke u ndërruar mes tyre në mënyrë rrotative, deri në fund të vitit, në mënyrë që secili kolegji të mbulojë muaj të ndryshëm gjatë vitit.

KOLEGJI PËR TË MITUR
1. Afrim Shala, kryetar
2. Mejreme Memaj, anëtare
3. Rasim Rasimi, anëtare

Anëtarët e kolegjit rezervë për kolegjin e të treve në lëmin penale
1. Java e I-rë Muhamet Rexha,
2. Java e II-të Beshir Islami,
3. Java e III-të Zenel Leku,
4. Java e IV-të Milena Djeric
5. Java e V-të Franciska Zhitija Ymeri,
6. Java e VI-të Rrustem Thaçi,
7. Java VII-të, Lumni Sallauka,
8. Java VIII-të, Nenad Lazic,
9. Java IX-të, Delushe Halimi.

Dega civile

Anëtarët e kolegjit të parë

1. Muhamet Rexha, kryetar

2. Zenel Leku, anëtar

3. Nenad Lazić , anëtar

Anëtarët e kolegjit të dytë

1. Beshir Islami, kryetar

2. Rustem Thaqi, anëtar

3. Milena Djeric, anëtare

Anëtarët e kolegjit të tretë

1. Rustem Thaqi, kryetar

2. Franciska Zhitija Ymeri, anëtare

3. Lumni Sallauka, anëtar

Kolegjet ndahen në muajt tek dhe çift në mënyrë rrotative, duke siguruar që çdo kolegji të mbulojë muajt të ndryshëm gjatë viteve për barazi dhe shpërndarje të ngarkesës.

Përcaktimi i ndarjes së punës për gjyqtarët e çështjeve civile në rastet e përjashtimit

1. Rustem Thaqi - Franciska Zhitija Ymeri

2. Milena Djeric – Beshir Islami,

3. Muhamet Rexha – Nenad Lazić

4. Zenel Leku - Lumni Sallauka

DEGA ADMINISTRATIVE

Kolegji i parë

Kolegji i parë është kujdestar në muajin tek

1. Ragip Namani, kryetar,
2. Delushe Halimi, anëtar
3. Franciska Zhitija Ymeri, anëtar.

Kolegji i dytë

Kolegji i dytë është kujdestar në muajt çift

1. Delushe Halimi, kryetar
2. Ragip Namani, anëtar
3. Lumni Sallauka, anëtar

Në kolegji vendosen të gjitha lëndët sipas mjeteve juridike të jashtëzakonshme dhe lëndët tjera administrative nëse me këtë orar nuk është përcaktuar që të vendosen në kolegji të veçantë. Eventualisht nëse kryetari i kolegjit në çështje administrative përjashtohet për shkaqe procedurale, i njëjti zëvendësohet nga gjyqtari Lumni Sallauka.

Kolegji për vendosjen në shkallë të tretë (neni 26 par.1.3 të Ligjit për Gjykatat)

Kolegji i parë

1. Mejreme Memaj, kryetare (neni 26 par 1. gjykata Supreme vendos në shkallë të tretë për ankesat e lejuara me ligj;)
2. Afrim Shala, anëtar dhe
3. Bashkim Hyseni, anëtar

Kolegji i dytë

1. Mejreme Memaj, kryetare,
2. Valdete Daka, anëtare dhe

3. Agim Maliqi, anëtar.
<i>Kolegji i tretë</i>
1. Mejreme Memaj, kryetare,
2. Burim Ademi, anëtar dhe
3. Rasim Rasimi, anëtar.

*Në mungesë të kryetarit të kolegjit, gjyqtari Agim Maliqi zëvendëson kryetarin.

Lëndët në kolegji vendosen në përputhje me mjete juridike të jashtëzakonshme, ndërsa lëndët penale të tjera vendosen në kolegji të veçantë vetëm nëse kjo nuk është përcaktuar me orarin e punës. Kryetari i Gjykatës do të përcaktojë një orar të veçantë sipas nevojës për të plotësuar kolegjet për çdo rast konkret.

Në rast përjashtimi të gjyqtarit nga çështja penale, lënda i ndahet në punë gjyqtarit sipas kësaj radhitjeje:

1. Valdete Daka – Agim Maliqi
2. Rasim Rasimi – Bashkim Hyseni
3. Mejreme Memaj – Agim Maliqi
4. Burim Ademi – Afrim Shala,

*Nëse ndonjëri nga gjyqtarët mungon nga kolegji penal për ndonjë arsye, atë e zëvendëson gjyqtari nga kolegji penal tjetër me radhitje të njëjta (p.sh. anëtarin e 3 (tretë) që mungon, e zëvendëson anëtari i 3 (tretë) i kolegjit tjetër e kështu me radhë.

Gjyqtarët e ngarkuar me unifikimin e praktikës gjyqësore, janë të ngarkuar me gjysmën e normës. Me rastin e ndarjes së lëndëve gjyqtarët në fjalë nuk ngarkohen me lëndë me radhë si gjithë gjyqtarët tjerë, por nëse ngarkohen një herë në rastin tjetër të radhës së ndarjes së lëndëve nuk përfshihen me gjyqtarët tjerë.

Ky orar i punës do të aplikohet prej datës së aprovimit në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme.

1.6 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Ky plan nuk përfshin mënyrën e organizimit të punës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, pasi UD- i Mbikëqyrësi është i obliguar të bëjë plan të veçantë.

2. Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme

Kryetari i gjykatës thërret seancat e përgjithshme me qëllim të adresimit të kërkesave për mendime juridike, qëndrime parimore dhe udhëzime të nevojshme për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe zgjidhjen e dilemave në zbatimin e ligjit. Seanca vjetore e gjyqtarëve, organizuar në fillim të vitit nga kryetari i gjykatës, shërben për analizën e punës së vitit të kaluar, vlerësimin e funksionimit të gjykatës, hartimin e planit vjetor të punës për vitin e ardhshëm dhe diskutimin e çështjeve të tjera të propozuara nga kryetari i gjykatës në bashkëpunim me gjyqtarët.

Pjesëmarrja në këto seanca është e detyrueshme dhe rendi i ditës përcaktohet nga kryetari i gjykatës, si dhe mund të propozohen edhe nga gjyqtarët. Staf i kabinetit të kryetarit, ndihmon në organizimin dhe zhvillimin e seancave të përgjithshme, duke njoftuar gjyqtarët së paku shtatëdhjetë e dy (72) orë para seancës dhe furnizon ata me materialet e rëndësishme për mbledhjen. Administratorja e gjykatës kujdeset për ruajtjen e procesverbalit dhe dokumentacionit për zhvillimin e mbledhjes, duke e dorëzuar paraprakisht ato te gjyqtarët për vërejtje. Më pas, procesverbalit i jepet miratimi në seancën tjetër dhe të gjitha dokumentet arkivohen në dosje të veçanta.

Kryetari i Gjykatës mund të thërret mbledhje të gjyqtarëve ose stafit për të diskutuar çështje të administrimit të gjykatës, organizimin e punës, arritjet dhe për të adresuar sfidat dhe problemet e punës.

3. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes

Orari i punës në Gjykatën Supreme është nga ora 08:00 deri në ora 16:00, ndërsa pushimi ditor është nga ora 12:00 deri në ora 13:00. Në rast se pushimi nuk mund të shfrytëzohet brenda këtij intervali, ai mund të merret jashtë orarit të përcaktuar, por vetëm brenda ditës së njëjtë.

Gjyqtarët dhe stafi i kabinetit të Kryetarit janë të obliguar të njoftojnë Kryetarin e Gjykatës për çdo mungesë gjatë orarit të punës, ndërsa stafi administrativ duhet të njoftojë U.D. administratorin e Gjykatës Supreme.

Të gjithë punonjësit e Gjykatës Supreme janë të obliguar të sillen në përputhje me korrektësinë dhe profesionalizmin gjatë orarit të punës, duke respektuar Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, si dhe Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Veshja dhe paraqitja e të gjithë zyrtarëve të gjykatës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e etikës dhe të pasqyrojnë denjësisht imazhin e institucionit, në pajtim me rregullat dhe ligjin në fuqi.

Përdorimi apo aktivitetet e zyrtareve të gjykatës, përfshirë gjyqtarët, në media apo në rrjetet sociale duhet të jenë të përgjegjshme dhe të paraqiten në mënyrë korrekte, ndërsa vendosja e fotografive dhe postimeve të ndryshme, duhet të jetë e kujdesshme në nivelin e paraqitjeve korrekte.

4. Zbatimi i programit TIK/SMIL

Në Gjykatën Supreme implementohet Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL). Me mbështetjen e zyrtarëve të teknologjisë informative të Gjykatës Supreme të gjitha lëndët ngarkohen në këtë sistem dhe raportet e të gjithë gjyqtarëve të nxjerrën vetëm përmes sistemit SMIL, përfshirë këtu edhe raportet e përgjithshme të gjykatës.

5. Implementimi i Sistemit të Përkthimeve

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e shërbimeve dhe efikasitetit të Gjykatës Supreme, do të implementohet një sistem i ri i përkthimeve. Ky sistem do të mundësojë përkthime të shpejta dhe të sakta për proceset dhe aktivitetet gjyqësore. Në fund të vitit 2024, janë krijuar llogaritë për të gjithë gjyqtarët dhe zyrtarët e gjykatave, dhe sistemi është lidhur drejtpërdrejt me Active Directory të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kjo lidhje është thelbësore për menaxhimin centralizuar dhe të sigurt të përdoruesve, duke siguruar që llogaritë të jenë të integruara në mënyrë efikase dhe të mbrojtura në përputhje me standardet më të larta të sigurisë dhe menaxhimit të të dhënave.

Implementimi i këtij sistemi do të kontribuojë në një menaxhim më të mirë të informacionit dhe do të lehtësojë qasjen në shërbime për të gjithë përdoruesit e sistemit

6. Transparenca dhe llogaridhënia

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuadër të juridiksionit të saj për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore dhe vendosjen e standardeve të praktikës gjyqësore, synon të përmirësojë performancën e sistemit gjyqësor përmes efikasitetit, cilësisë dhe rritjes së besueshmërisë së publikut. Si pjesë e këtij angazhimi, gjykata ka ndërmarrë hapa konkretë për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, duke siguruar informimin e përditshëm të qytetarëve përmes publikimeve në ueb-faqen zyrtare dhe llogarinë e saj në Facebook. Përmes publikimit të aktgjykimeve, aktvendimeve, mendimeve juridike dhe dokumenteve të tjera relevante, gjykata ofron qasje të hapur dhe të plotë për publikun.

6.1 Praktika Gjyqësore

Unifikimi i praktikës gjyqësore mbetet një nga prioritetet kryesore të Gjykatës Supreme, i cili kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe forcimin e besueshmërisë publike.

Për të arritur këtë objektiv, Gjykata Supreme do të identifikojë dhe analizojë problemet që hasen në praktikë. Përmes takimeve të brendshme të kolegjeve civile dhe penale, do diskutohen çështjet që kërkojnë harmonizim dhe do të sigurohet një qasje e unifikuar në zbatimin e ligjit. Këto takime të kolegjeve, do të luajnë një rol kyç në këtë drejtim, duke ndihmuar në adresimin e sfidave dhe përcaktimin e standardeve për interpretimin e ligjit.

Për më tepër, Gjykata Supreme do të organizojë takime me gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë, do të organizojë takime dhe punëtori në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë. Po ashtu, ajo do të zhvillojë takime me partnerë ndërkombëtarë për të shkëmbyer përvoja dhe për të harmonizuar standardet vendore me ato ndërkombëtare.

Gjithashtu, gjykata do të angazhohet në përgatitjen e përmbledhjeve të praktikës gjyqësore, të cilat shërbejnë për gjykatat e instancave më të ulëta si një mjet i rëndësishëm për zbatimin e ligjit në mënyrë të harmonizuar dhe të unifikuar.

7. Administrata Gjyqësore

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të administrojë ud. administratorja e Gjykatës Supreme, Vjollca Cenaj, të cilën e zëvendëson në rast mungese Antigona Uka-Lutfiu.

Ud. administratorja menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të gjykatës në mënyrë autonome, në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

8. Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore

Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore, i formuar në gusht të vitit 2018, ka misionin e zhvillimit dhe monitorimit të politikës ndëshkimore në vend. Gjatë vitit 2025, komisioni do të vazhdojë aktivitetet dhe angazhimin e tij për unifikimin e politikës ndëshkimore, me mbështetje të vazhdueshme nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, Akademia e Drejtësisë, dhe partnerët tjerë. Pas miratimit të Udhëzuesit për Matjen e Dënimit, i cili ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2024, ky vit planifikohet të shënojë realizimin e takimeve me gjyqtarët e gjykatave themelore dhe atyre të apelit, me qëllim implementimin e këtij udhëzuesi të ri.

Komisioni do të funksionojë me përbërjen e mëposhtme gjatë vitit 2025:

1. **Fejzullah Rexhepi**, Kryetar i Gjykatës Supreme – Kryesues i Komisionit,
2. **Agron Qalaj**, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit – anëtar,
3. **Agim Maliqi**, Gjyqtar në Gjykatën Supreme – anëtar,
4. **Bashkim Hyseni**, Gjyqtar në Gjykatën Supreme – anëtar,
5. **Albina Shabani Rama**, Kryetare e Gjykatës Themelore Prishtinë – anëtare,
6. **Enver Fejzullahu**, Drejtor i Akademisë së Drejtësisë – anëtar.

10. Bashkëpunimi me institucionet të tjera

Gjykata Supreme e Kosovës gjatë vitit 2025, do të vazhdojë bashkëpunimin e saj të mirëfilltë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese dhe Policinë e Kosovës. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi me Ambasadën Amerikane në Prishtinë dhe organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare si USAID, UNDP, CHEMONICS, OSBE, ROLAG, IKD, BIRN, GLSP, CLARD etj.

Në këtë kontekst, Gjykata Supreme planifikon të zhvillojë takime, vizita në Gjykata, konferenca dhe aktivitete të tjera me qëllim të përmirësimit të sundimit të ligjit në vend, shqyrtimit të çështjeve gjyqësore dhe politikës ndëshkimore, si dhe ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor.

Gjykata Supreme do të vazhdojë të bëjë analiza të rregullta të praktikës së saj dhe të publikojë përmbledhjet e praktikës gjyqësore për të ndarë përvojën dhe të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së vendimeve gjyqësore.

Përfundimi

Gjykata Supreme ka bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e sistemit gjyqësor të Kosovës dhe ka siguruar mbështetje të vazhdueshme nga Ambasada Amerikane në Kosovë për analizimin dhe përmirësimin e politikës ndëshkimore. Bashkëpunimi me Komisionin Konsultativ për Politikë Ndëshkimore do të vazhdojë në vitin 2025, duke përfshirë një partneritet të ngushtë për unifikimin e praktikës dhe zbatimin e udhëzuesit të ri për matjen e dënimeve.

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për ruajtjen e sundimit të ligjit, sigurisë juridike dhe drejtësisë, duke kontribuar në forcimin e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor. Si pjesë e angazhimit të saj, Gjykata Supreme do të realizojë aktivitete që përmirësojnë transparencën dhe llogaridhënien, duke organizuar takime, konferenca dhe duke krijuar platforma për shkëmbimin e ideve dhe përvojave me partnerët ndërkombëtarë dhe aktorët kyç në fushën e drejtësisë.

Gjykata do të sigurojë një qasje të hapur dhe transparente për qytetarët, duke ndarë informacion të rëndësishëm në lidhje me punën e saj përmes ueb-faqes zyrtare dhe platformave sociale.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, zbatohet nga **01.01.2025**.

Obligohet Zyra për Informim, të publikoj këtë plan/program në ueb faqen e gjykatës.

Fejzullah Rexhepi



Kryetar i Gjykatës Supreme

Datë: 09.01.2024

Me këtë plan do të njoftohet:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

ANEKS - Organogrami i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Gjykata Supreme drejtohet nga kryetari, Fejzullah Rexhepi, dhe ka nënkryetaren dhe gjyqtarët si pjesë përbërëse të saj. Mëposhtë janë pasqyruar pozitat aktuale sipas organogramit të gjykatës:

- **Kabineti i Kryetarit** përbëhet nga: Rina Koliqi – Këshilltare e Lartë, Fatmir Geca – Këshilltar, Blerta Ferizi – Zyrtare Ekzekutive, Besnik Karaliti – vozitës.
- **Zyra për Media dhe Informim** përbëhet nga: Antigona Uka Lutfiu – Udhëheqëse.
- **Zyra e Administratores** e cila përbëhet nga: Vjollca Cenaj – U.D. Administratore.
- **Bashkëpunëtorë profesional:** Minire Xhambazi, Sherif Krasniqi, Qefsere Berisha, Bujar Balaj, Mirlinda Mejzini, Faton Xhaqaj, Drilona Kajtazi, Zanë Buçinca.
- **Zyrtar ligjor/Sekretar Juridik:** Nerimane Janjevaliu, Vjollca Maxhuni, Sveta Simic, Ganimete Salihu, Meleqe Gashi Maloku.
- **Zyra për Buxhet dhe Financa** e cila përbëhet nga: Miradije Maqedonci – Udhëheqëse, Faton Thaçi – Zyrtar Shpenzues, Rabishe Lika – Zyrtare për të Hyra
- **Referent:** Florije Krasniqi, Shukri Miftari, Miroslav Milijkovic, Valdete Krasniqi (e cila gjendet në pushim pa pagesë).
- **Certifikues** – Nadire Vllasaliu
- **Zyrtar i Personelit** – Fikrije Azemi
- **Zyrtar i TI** – Vllaznim Makolli
- **Zyrtare për përkthim** – Drita Kelmendi
- **Arkivist** – Besim Vllasaliu
- **Mirëmbajtëse:** Elheme Nimani

Në fund të vitit 2024, organogrami i Gjykatës Supreme është plotësuar me pozita të reja. Sipas Rregullores Nr. 21/2024 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 05/2021 për organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Supreme, e miratuar më 27 dhjetor 2024, është shtuar **Zyra për Hulumtim, Publikim dhe Monitorim**.

Zyra e re përbëhet nga këto pozita:

1.1 Koordinator i Zyrës, 1.2 Hulumtues për Qëndrimet Parimore dhe Zbatimin Unik të Ligjeve, dhe 1.3 Monitorues.

Pozitat e paplotësuara sipas organogramit:

1. Administrator- një pozitë
2. Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike - një pozitë
3. Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e lëndëve - një pozitë

4. Udhëheqës i Zyrës për Shërbime të Përbashkëta - një pozitë
5. Lektor - një pozitë
6. Zyrtar për Përkthime - një pozitë
7. Dorëzues - një pozitë
8. Receptonist- një pozitë
9. Depoist - një pozitë
10. Zyrtar për Informim dhe Komunikim me Media - një pozitë
11. Vozitës – një pozitë
12. Zyrtar Logjistike – një pozitë

